

**ENTI RREGULLATOR I UJIT**



## **SHOQËRIA RAJONALE UK DURRËS**

**ANALIZA E HUMBJEVE TË UJIT PËR VITIN 2022**

**Tiranë, 2023**

**Bilanci i Ujit  
dhe  
Analiza e Humbjeve të Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Durrës**

**I. Të Përgjithshme mbi Hartimin e Bilancit të Ujit**

ERRU harton çdo vit Raportin e Bilancit të Ujit për shoqëritë që operojnë në Sektorin Ujësjellës - Kanalizime. Ky raport merr një rëndësi të veçantë për një menaxhim racional të sektorit sepse trajton në mënyrë të veçantë treguesin e Ujit Pa të Ardhura, pra humbjet e ujit. Treguesi UPA lidhet ngushtësisht me cilësinë e shërbimeve që shoqëritë i ofrojnë konsumatorëve si edhe me qëndrueshmërinë financiare të tyre.

Organizimi i ri i shoqërive, në 15 shoqëri rajonale në sektorin UK, ka sjellë nevojën për një strukturim të ri të analizës mbi UPA dhe “Bilancin e Ujit” në tërësi. Analiza e humbjeve të ujit për çdo shoqëri rajonale kryhet duke analizuar fillimisht Bilancin e Ujit më vete për çdo njësi (ish shoqëri UK) që tashmë është nën administrimin e shoqërisë rajonale të krijuar dhe më pas analiza bëhet në mënyrë të integruar për shoqërinë rajonale në tërësi. Kjo qasje mundëson vënien në pah të problematikave individuale të çdo njësie të cilat duhet të kihet parasysh në të ardhmen për zgjidhjen apo përmirësimin e tyre.

Kjo analizë i vjen në ndihmë çdo shoqëri rajonale duke i mundësuar asaj që nëpërmjet analizës së komponentëve përbërës të Bilancit të Ujit, për çdo njësi dhe në tërësinë e shoqërisë rajonale, të njihet në mënyrë analitike me nivelin e humbjeve (UPA), të nën komponentëve të saj, arsyet e veçanta të nivelit të lartë të humbjeve të ujit, nevojën dhe mënyrën e monitorimit të humbjeve, problematikat e faturimit më matje dhe aforfe, si dhe rekomandimet që ERRU jep për çdo shoqëri UK për të realizuar përmirësimet e nevojshme në punën e tyre.

“Bilanci i Ujit” si një instrument mjaft i rëndësishëm në përmirësimin e treguesit kryesor të performancës UPA, duhet të hartohet më të dhëna sa më të sakta pasi hapat që do të ndërmerren për reduktimin e tij lidhen ngushtësisht edhe me qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë. Si model i hartimit të Bilancit të Ujit do të përdoret ai i IWA (Shoqërisë Ndërkombëtare të Shoqërive të Ujësjellësve).

Duke patur parasysh gjendjen teknike të sistemeve të furnizimit më ujë si mungesën e matësve në burim, mos organizim të rrjeteve shpërndarëse bazuar në konceptin e Zonave më Matje të Pavarura (DMA-të), mangësitë në mjetet dhe metodat e monitorimit të konsumit, është vendosur që si metodologji e llogaritjes së nën komponentëve të Bilancit të Ujit të përdoret ajo nga “lart-poshtë” (top-down), ku fokusi kryesor në llogaritjen e humbjeve totale është përcaktimi i humbjeve të dukshme, dhe më tej përcaktohen ato reale.

**II. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Durrës**

Shoqëria rajonale UK Durrës u krijua nga bashkimi i ish shoqërive UK ose Njësitë, përkatësisht UK Durrës, Krujë, Kavajë dhe Rrogozhinë.

Të dhëna të përgjithshme në lidhje me popullsinë e shërbyer, konsumin për banor me matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit të Sh. R UK Durrës jepen në **tabelën 1**.

Nga të dhënat e Tabelës 1, probleme të nën faturimit me matje për klientë familjare konstatohet për ish shoqëritë Krujë (45.5 l/ditë për banor) dhe Rrogozhinë (66.3 l/ditë për banor). Duke patur parasysh furnizimin me orar të kufizuar në njësinë Krujë dhe Rrogozhinë, niveli mjaft i ulët i konsumit (shih tabelën 1) kërkon një analizë të thelluar nëse ky konsum vjen si rezultat i orarit të

kufizuar të furnizimit me ujë, kapaciteteve jo të mjaftueshme të burimeve ujore që furnizojnë këto njësi apo nga prania e mundshme e lidhjeve dyfishe nga konsumatorët.

**Tabela Nr. 1** Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe

Sh. R. Durrës	Popullsia me shërbim	Konsumi Total (në m <sup>3</sup> )	Konsumi i matur (në m <sup>3</sup> )	Konsumi i pamatur (në m <sup>3</sup> )	Nr. lidhjeve me matës	Nr. lidhjeve pa matës	Konsumi i Matur	Konsumi Aforfe	Konsumi Total
							(l/ditë, banor)		
Durrës	202,675	7,551,000	6,894,000	657,000	83,078	3,080	96.6	248.4	102.1
Kruje	35,300	699,300	444,000	255,300	4039	1,299	<b>45.5</b>	81.4	<b>54.3</b>
Kavaje	31,485	1,129,000	403,000	726,000	10,264	14,552	84.8	107.7	98.2
Rrogozhine	11,584	302,000	266,000	36,000	5,052	271	<b>66.3</b>	167.2	<b>71.4</b>
<b>Shuma</b>	<b>281,044</b>	<b>9,681,300</b>	<b>8,007,000</b>	<b>1,674,300</b>	<b>102,433</b>	<b>19,202</b>	<b>92.7</b>	<b>103.4</b>	<b>94.4</b>

Probleme me nën faturimin aforfe paraqiten njësitë Krujë dhe Kavajë të cilat duhet të analizojnë arsyet e këtij nën faturimi (nëse përfshijnë në të dhe klientët jo aktive), sepse dihet që konsumi mesatar për banor për këtë lloj faturimi referuar VKM nr.102, datë 16.03.1992 duhet të jetë 150 litra në ditë. Referuar po këtij vendimi, ish shoqëria UK Durrës dhe Rrogozhinë duhet të analizojnë me kujdes të dhënat mbi volumet e faturuara dhe numrin e klientëve të faturuar aforfe, për të gjetur dhe arsyet e këtij mbi faturimi.

Nga ana tjetër referuar **tendencës së rritjes së vazhdueshme të kërkesës për ujë**, si dhe problematikat e pritshme të rezervave ujore për shkak të ndryshimeve klimatike duhet bërë një vlerësim i këtyre rezervave në krahasim me plotësimin e kërkesës për ujë, të paktën asaj aktuale. Për këtë qëllim në tabelën 2, krahas volumit të ujit të prodhuar dhe konsumit për popullsinë e shërbyer jepen dhe burimet ujore respektive dhe kapacitetet e tyre.

**Tabela 2.** Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve

Sh. R Durrës	Popullsia* e Shërbyer	Uji i Prodhuar që futet në sistem (në m <sup>3</sup> )	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe (l/ditë, banor)	Popullsia* e Regjistruar në Zonën e Shërbimit	Burimet dhe Kapaciteti i Tyre (në m <sup>3</sup> /vit)	Sasia e Disponueshme e Ujit (l/ditë, banor)	Diferenca në Plotësimin e Kërkesës (l/ditë, banor)
Durrës	202,675	43,638,723	102.1	229,983	30,817,000	417	+314
Kruje	35,300	2,646,475	54.3	59,814	4,727,000	367	+313
Kavaje	31,485	8,439,000	98.2	31,485	2,757,300	240	+142
Rrogozhine	11,584	857,801	71.4	17,542	767,200	181	+110
<b>UK Durrës Rajonale</b>	<b>281,044</b>	<b>55,581,999</b>	<b>94.4</b>	<b>338,824</b>	<b>39,068,500</b>	<b>381</b>	<b>+286</b>

\* Popullsia në juridiksion u korrigjua duke u bazuar në të dhënat e INSTAT-it të publikuara në rang qarku në Janar të vitit 2023, ndërsa për popullsinë në shërbim si bazë përlogaritje shërbeu mbulimi me shërbim i raportuar nga vetë shoqëritë UK.

Nga tabela 2 shihet se **shoqëria rajonale UK Durrës ka burime të mjaftueshme ujore për plotësimin e kërkesës për ujë në zonën e saj të shërbimit**. Në fokusin e shoqërisë rajonale duhet të jetë mbrojtja e burimeve nëpërmjet shfrytëzimit me efikasitet të burimeve ujore të disponueshme, duke u bazuar në prodhimin sipas kërkesës për ujë, si dhe reduktimin e humbjeve të ujit në të gjitha njësitë përbërëse për të arritur dhe objektivin final "kohëzgjatje të furnizimit me ujë në 24/7" për çdo njësi furnizimi si dhe sigurimin e ujit për brezat e ardhshëm.

## II.1 UPA për ish Shoqërinë UK Durrës

Gjatë vitit 2022, ish shoqëria UK Durrës ka prodhuar 43,638,723 m<sup>3</sup> ujë, **volum i cili raportohet i matur në nivelin 100%**. Shërbimi i furnizimit me ujë ofrohet për rreth 88% të popullsisë në juridiksion ndërsa numri i lidhjeve me ujin rezulton 93,633 lidhje nga të cilat 90,515 lidhje janë të pajisur me matës.

**Faturimi total rezulton në nivelin 21.4% ndërsa "UPA" në nivele mjaft të pakënaqshme 78.60%.** Rreth 34.46% të prodhimit humbet nga lidhjet e paligjshme për të cilat shoqëria duhet të organizohet seriozisht për ti kthyer ato në të ligjshme. Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë nuk është i organizuar në zona të pavarura me matje (DMA) për të gjithë zonën e shërbimit, për rrjedhojë monitorimi i humbjeve nuk mund të bëhet i detajuar për të gjithë sistemin. Kjo gjendje vështirëson monitorimin efikas të humbjeve dhe njëkohësisht bëhet pengesë gjatë ndërtimit të strategjive për zvogëlimin e humbjeve me orientim prioriteti në DMA-të më problematike.

**Në tabelën 3** paraqitet bilanci i ujit si dhe komponentët përbërës të tij për ish shoqërinë UK Durrës.

**Tabela 3.** Bilancit i Ujit për ish Shoqërinë Durrës- Viti 2022.

Emërtimi	Viti 2022	Ndaj Ujit të Prodhuar (në%)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	43,638,723	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	8,674,121	19.88%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	665,522	1.53%
<b>Faturimi total</b>	<b>9,339,643</b>	<b>21.40%</b>
<b>Konsumi i autorizuar i pa faturuar</b>	<b>0</b>	<b>0.00%</b>
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit	10,582,095	24.25%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës	4,456,983	10.21%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	805,000	1.84%
<b>Humbjet e dukshme (administrative)</b>	<b>15,844,078</b>	<b>36.31%</b>
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	3,181,875	7.29%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	436,375	1.00%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit	436,375	1.00%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes	13,527,627	31.00%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjellësit	872,750	2.00%
<b>Humbjet Reale të ujit (teknike)</b>	<b>18,455,002</b>	<b>42.29%</b>
<b>Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)</b>	<b>34,299,080</b>	<b>78.60%</b>
<b>UJI PA TË ARDHURA</b>	<b>34,299,080</b>	<b>78.60%</b>

**Komente :**

- UPA në nivelin 78.60% të prodhimit vjetor, konsiderohet në nivele mjaft të larta dhe i papranueshëm.
- Volumi i ujit të prodhuar raportohet i matur në nivelin 100% ndërsa faturimi total ndonëse matet në nivelin 92.4%, duhet të synohet në faturimin 100% me matje për të gjitha kategoritë e konsumatorëve.
- Niveli i humbjeve fizike (42.29%) shkaktohen kryesisht në rrjetin e transmetimit (7.29%) dhe veçanërisht në rrjetin shpërndarës (31.00%) konsiderohet mjaft i lartë. Shoqëria duhet të verifikojë nëse ekzistojnë të regjistruara në evidenca të cilat vërtetojnë çarje mjaft të shpeshta të linjave të transmisionit, gjendje fizike të përkeqësuar të rrjeteve të shpërndarjes etj.
- Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të ujësjellësit në nivelin 2% konsiderohen të larta, shoqëria duhet të bëjë kujdes që për riparimet e defekteve duhen mbajtur evidenca të sakta mbi numrin e çarjeve dhe konsumin e kryer gjatë riparimit të çdo defekti.
- Faturimi total realizohet në nivel të ulët (21.40% e prodhimit) ndërsa Konsumi i Autorizuar i Pa Faturuar është neglizhuar në përllogaritje. Shoqëria UK Durrës duhet të këtë konsumuar ujë për nevojat e veta të cilat duhet të ishin pasqyruar në këtë bilanc.

### Rekomandime:

- Në lidhje me përqindjen e lartë të lidhjeve të paligjshme, Njësia duhet të ndërmarrë një plan veprimi për të përcaktuar sa më saktësisht bazën e klientëve, që krahas verifikimeve në terren (task force) të krahasohet edhe me bazën e klientëve të OSHEE-së, si edhe me verifikime në vend për anashkalim të ujëmatësit me lidhje dytësore.
- Të thellohet në analizën për të përcaktuar se ku ekziston saktësisht problematika me ujin e faturuar aforfe i cili rezultoi në nivele mjaft të larta (248.4 l/banorë në ditë), si kontroll i punës së lexuesve të matësve, për të verifikuar sa klientë faturohen aforfe dhe se sa është numri i banorëve për çdo lidhje bazuar në certifikatën familjare të vitit aktual.
- Për humbjet reale të larta në linjat e transmetimit dhe rrjetin shpërndarës, urgjentisht të planifikohen fonde nga qeveria qendrore ose me fondet e veta për riparimin e tyre.
- Shoqëria të shoh si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve, për të diagnostikuar ku janë problemet më të mëdha me humbjet, në bazë të cilave do të hartohen planet e masave për zvogëlimin e tyre.

### II.2 UPA për ish Shoqërinë UK Krujë

Shërbimi i furnizimit me ujë në Njësinë Administrative Krujë ofrohet për 59% të popullsisë në juridiksion. Prodhimi vjetor i vlerësuar raportohet 2,646,475 m<sup>3</sup> ujë dhe **rezultoni i matur në nivelin 83%**. Numri i lidhjeve me ujin raportohet 6,15 lidhje, ku 4,761 lidhje janë të pajisur me ujëmatës ndërsa pjesa tjetër faturohet aforfe.

Faturimi Total rezulton në nivelin 30.34% të prodhimit ndërsa **“Uji Pa të Ardhura” qëndron në nivele mjaft të pakënaqshme (69.66%)**. Monitorimi i humbjeve në rrjetin shpërndarës nuk bëhet në bazë të DMA-ve. Shoqëria shpesh herë ka paraqitur vështirësi në hartimin e bilancit të ujit. **Në Tabelën 4** paraqiten komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për ish shoqërinë UK Krujë.

**Tabela 4.** Bilanci i Ujit për Ish Shoqërinë UK Krujë – Viti 2022

Emërtimi	Viti 2022	Ndaj Ujit të Prodhuar (në%)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	2,646,475	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	533,600	20.16%
Konsumi i ujit të faturuar i pa matur	269,320	10.18%
<b>Faturimi total</b>	<b>802,920</b>	<b>30.34%</b>
<b>Konsumi i autorizuar i pa faturuar</b>	<b>39,697</b>	<b>1.50%</b>
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit	364,272	13.76%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës	396,971	15.00%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	153,648	5.81%
<b>Humbjet e dukshme (administrative)</b>	<b>914,891</b>	<b>34.57%</b>
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	203,878	7.70%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	80,000	3.02%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit	60,000	2.27%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes	539,697	20.39%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjetës	5,392	0.20%
<b>Humbjet Reale të ujit (teknike)</b>	<b>888,967</b>	<b>33.59%</b>
<b>Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)</b>	<b>1,803,858</b>	<b>68.16%</b>
<b>UJI PA TË ARDHURA</b>	<b>1,843,555</b>	<b>69.66%</b>

### Komente :

- UPA rezulton në nivele mjaft të larta e të pakënaqshme( 69.66% të prodhimit vjetor).

- Humbjet e shkaktuara nga konsumi i ujit i autorizuar i pa faturuar janë 1.5% e prodhimit vjetor dhe shkaktojnë humbje financiare të konsiderueshme për shoqërinë dhe që duhet të korrigjohet nën vlerat e lejuara.
- Humbjet administrative në nivelin 34.57% të prodhimit shkaktohen kryesisht nga lidhjet e paligjshme në rrjetet e transmetimit (13.76%) dhe të shpërndarjes (15.00%). Këto humbje konsiderohen mjaft të larta dhe të papranueshme pasi kanë një impakt financiar negativ për shoqërinë.
- Niveli i humbjeve teknike 33.59%, rezulton kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës (20.39%) dhe atë të transmetimit (7.70%) dhe konsiderohen të pa pranueshme dhe që duhen analizuar në terren për shkaqet dhe mundësinë e uljes së tyre.

#### **Rekomandime:**

- Në lidhje me përqindjen e lartë të mundshme të lidhjeve të paligjshme, Njësia duhet të ndër marrë plan veprimi për të përcaktuar sa më saktësisht bazën e klientëve, që krahas verifikimeve në terren (task-forcë) të krahasohet edhe me bazën e klientëve të OSHEE-së, si edhe me verifikime në vend për anash kalim të ujëmatësimit me lidhje dytësorë.
- Shoqëria të shoh si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve, për të diagnostikuar ku janë problemet më të mëdha me humbjet, në bazë të cilave do të hartohen planet e masave për zvogëlimin e tyre.
- Të merren masa për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e ujëmatësive në çdo burim në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real dhe të kemi një prodhim të matur në nivelin 100%.

### **II.3 UPA për ish Shoqërinë UK Kavajë**

Shërbimi i furnizimit me ujë në Njësinë Administrative Kavajë raportohet për 100% të popullsisë në juridiksion. Prodhimi vjetor në sasinë 8,439,000 m<sup>3</sup> ujë, raportohet i vlerësuar pasi **asnjë nga burimet e shfrytëzueshme nuk është i pajisur me aparat ujëmatës.**

Faturimi Total rezulton 37.71% e prodhimit, ndërsa **“Uji Pa të Ardhura” në nivelin 62.29%**. Ish shoqëria UK Kavajë raporton 26,334 lidhje me ujin nga të cilat 10,872 lidhje janë të pajisur me matës. **Në Tabelën 5** paraqiten komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për ish shoqërinë UK Kavajë.

**Tabela 5. Bilanci i Ujit për ish Shoqërinë UK Kavajë – Viti 2022**

Emërtimi	Viti 2022	Ndaj Ujit të Prodhuar (në%)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	8,439,000	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	2,182,000	25.86%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	1,000,000	11.85%
<b>Faturimi total</b>	<b>3,182,000</b>	<b>37.71%</b>
<b>Konsumi i autorizuar i pa faturuar</b>	<b>25,000</b>	<b>0.30%</b>
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit	800,000	9.48%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës	1,000,000	11.85%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	850,000	10.07%
<b>Humbjet e dukshme (administrative)</b>	<b>2,650,000</b>	<b>31.40%</b>
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	600,000	7.11%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	150,000	1.78%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit	300,000	3.55%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes	1,523,000	18.05%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjellësit	9,000	0.11%
<b>Humbjet Reale të ujit (teknike)</b>	<b>2,582,000</b>	<b>30.60%</b>
<b>Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)</b>	<b>5,232,000</b>	<b>62.00%</b>
<b>UJI PA TË ARDHURA</b>	<b>5,257,000</b>	<b>62.29%</b>

### **Komente:**

- UPA rezulton në nivel të pakënaqshëm (**62.29%**), dhe shkaktohen kryesisht në nivelin 31.40% nga humbjet administrative si pasojë e numrit të lartë të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës dhe transmetimit. Gjithsesi, vërtetësia e të dhënave për nivelin e UPA duhet verifikuar në terren.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në zona të ndara me matje (DMA). Formati i “Bilancit të Ujit” nuk është dorëzuar për vitin 2022, të dhënat janë plotësuar nga Sektori Teknik i ERRU-së mbi bazën e nivelit të humbjeve të komponentëve përbërës të vitit paraardhës (2021) dhe të dhënave të raportuara në Njësinë e Monitorimit.
- Pasaktësia e mundshme në llogaritjen e sasisë së ujit të prodhuar 100% me vlerësim (jo me matje), vështirësitë në hartimin e bilancit të ujit, mungesa e DMA-ve etj, vë në dyshim vërtetësinë e vlerës absolute të volumit të ujit të prodhuar dhe njëkohësisht nivel të pabesueshëm të treguesit UPA.
- Humbjet teknike janë në nivelin 30.60% të prodhimit vjetor, ku 18.05% i atribuohen rrjetit shpërndarës dhe 7.11% linjave të transmetimit. Reduktimi i tyre duhet të jetë në fokusin e shoqërisë, gjithashtu duhet të tregohet kujdes edhe në reduktimin e humbjeve nga rrjedhjet në depot e ujit (3.55%) të cilat rezultojnë mbi normat e lejuara.
- Rreth 69% e konsumit total faturohet me matje, ndërsa 41.3% e konsumatorëve publike janë të pajisur me matës individuale duke përfaqësuar një nivel të pakënaqshëm të matjes.

### **Rekomandime:**

- *Duke patur parasysh që asnjë burim furnizimi me ujë nuk është i pajisur me ujëmatës nevoja për investime në ujëmatës në prodhim është e domosdoshme dhe imediate, shoqëria duhet të marrë masa urgjente për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre, në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.*
- *Shoqëria duhet të gjejë fonde për të rritur përqindjen e konsumatorëve familjare me matës që ky tregues të jetë sa më afër nivelit 100%, për të patur konsumatorë të mbrojtur nga faturimi jo korrekt dhe një nivel të Ujit Pa të Ardhura sa më real.*
- *Duke patur parasysh mangësitë dhe vështirësitë në raportimet e vlerave të Bilancit të ujit që ka demonstruar stafi i shoqërisë, është i domosdoshëm trajnimi i stafit si dhe caktimi i një personi përgjegjës për monitorimin e humbjeve, saktësimin e të dhënave si dhe hartimin e bilancit të ujit për gjatë gjithë muajve të vitit.*
- *Shoqëria të shoh si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve, për të diagnostikuar ku janë problemet më të mëdha me humbjet, në bazë të të cilave do të hartohen planet e masave për zvogëlimin e tyre.*

#### **II.4 UPA për ish Shoqërinë UK Rrogozhinë**

Në Njësinë Administrative Rrogozhinë shërbimi i furnizimit me ujë ofrohet për rreth 66% të popullsisë në juridiksion. **Prodhimi vjetor i vlerësuar** raportohet në sasinë 857,801 m<sup>3</sup> ndërkohë që uji që humbet dhe nuk gjeneron të ardhura (**UPA**) rezultoi në nivelin **61.72%**.

Konsumi i Faturuar raportohet në nivelin 38.28% e prodhimit vjetor. Konsumi i Autorizuar i pa Faturuar në nivelin 3.13% e prodhimit, ndërkohë që shoqëria duhet të konsumoje për nevojat e veta rreth 1% të ujit të prodhuar.

Numri total i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë raportohet 5,644 lidhje nga të cilat 5,356 lidhje faturohen me matje ndërsa pjesa tjetër aforfe. Lidhjet e paligjshme në rrjetin e shpërndarjes dhe të transmetimit raportohen në nivelin 30% e prodhimit, prandaj aksioni për eliminimin e tyre është emergjent.

**Në Tabelën 6** paraqitet Bilancit të Ujit dhe komponentët përbërës të tij.

**Tabela 6.** Bilanci i Ujit për Ish Shoqërinë UK Rrogozhinë– Viti 2022

Emërtimi	Viti 2022	Ndaj Ujit të Prodhuar (në%)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	857,801	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	297,075	34.63%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	31,280	3.65%
<b>Faturimi total</b>	<b>328,355</b>	<b>38.28%</b>
<b>Konsumi i autorizuar i pa faturuar</b>	<b>26,885</b>	<b>3.13%</b>
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit	80,065	9.33%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës	177,483	20.69%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	61,766	7.20%
<b>Humbjet e dukshme (administrative)</b>	<b>319,314</b>	<b>37.22%</b>
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	33,355	3.89%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	22,766	2.65%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit	8,471	0.99%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes	116,478	13.58%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjetës	2,177	0.25%
<b>Humbjet Reale të ujit (teknike)</b>	<b>183,247</b>	<b>21.36%</b>
<b>Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)</b>	<b>502,561</b>	<b>58.59%</b>
<b>UJI PA TË ARDHURA</b>	<b>529,446</b>	<b>61.72%</b>

**Komente:**

- UPA 61.72%, rezulton në nivele të pakënaqshme dhe paraqet nevojën emergjente për përmirësim të nivelit aktual nëpërmjet një plan veprimi të hartuar nga shoqëria.
- Raportohet se 95% e konsumatorëve familjare janë të pajisur me ujëmatës ndërkohë që të dhënat e tabelës 1 tregojnë norma faturimi jo korrekte si në faturimin me matje dhe atë aforfe, gjë që nuk bën sens në raportimin mbi numrin e lidhjeve të cilat duhet të jenë subjekt verifikimi për saktësinë e tyre.
- Prodhimi vjetor nuk matet por përcaktohet me vlerësim ndërkohë që konsumi i faturuar matet në nivelin 90.5%.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në zona të ndara me matje (DMA). Për hartimin e “Bilancit të Ujit” nuk është emëruar një person përgjegjës dhe bilanci nuk hartohet bazuar në monitorimin vjetor të të dhënave.
- Humbjet teknike (21.36%) të shkaktuara kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës (13.58%) dhe ato të transmetimit (3.89%) raportohen më të ulëta se nivelet e pranuar gjatë projektimit, kjo tregon edhe njëherë nevojën e trajnimit për stafin teknik dhe saktësimin e të dhënave mbi humbjet dhe komponentët përbërës të tij.



- Konsumi i Autorizuar i Pa Faturuar (3.13%) rezulton në nivelet mjaft të larta, konsumi për nevojat e shoqërisë së bashku me konsumin që ata kanë vendosur të falin, rezulton mbi normat e lejuara (1%).
- Humbjet e administrative, nga lidhjet e paligjshme në transmetim (9.33%) dhe në shpërndarje (20.69%) janë në nivele mjaft të larta, pasi sjellin dëme financiare të mëdha për qëndrueshmërinë e shoqërisë.

#### **Rekomandime:**

- *Duke patur parasysh që asnjë burim furnizimi me ujë nuk është i pajisur me ujëmatës nevoja për investime në ujëmatës në prodhim është e domosdoshme dhe imediate, prandaj shoqëria duhet të marre masa urgjente për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.*
- *Duke patur parasysh mangësitë dhe vështirësitë nga stafi i shoqërisë në raportimet e vlerave të Bilancit të ujit, është i domosdoshëm trajnimi i tij si dhe caktimi i një personi përgjegjës për monitorimin e humbjeve, saktësimin e të dhënave si dhe hartimin e bilancit të ujit përgjatë gjithë muajve të vitit.*
- *Shoqëria të ketë si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve, për të diagnostikuar ku janë problemet më të mëdha me humbjet, në bazë të të cilave të hartohen planet e masave për zvogëlimin e tyre.*
- *Në lidhje me përqindjen e lartë të lidhjeve të paligjshme, Njësia duhet të ndërmarrë plan veprimi për të përcaktuar sa më saktësisht bazën e klientëve, që krahas verifikimeve në terren (task force) të krahasohet edhe me bazën e klientëve të OSHEE-së, si edhe me verifikime në vend për anashkalim të ujëmatësit me lidhje dytësore.*

### **III Përmbledhëse e UPA për Shoqërinë Rajonale UK Durrës**

**Shoqëria Rajonale UK Durrës**, e krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK Kavajë, Krujë dhe Rogozhinë, ka nën juridiksion 338,824 banorë.

Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë realizohet vetëm për 281,044 banorë ose **83%** të popullsisë totale.

Numri i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë raportohet 131,763 lidhje, nga të cilat 102,433 lidhje janë të pajisur me aparate ujëmatës.

**Prodhimi vjetor 55,581,999 m<sup>3</sup> rezulton i matur në nivelin 83%**, nevoja për aparateve ujëmatës në pikat prodhuese është imediate kryesisht për burimet e shfrytëzueshme të njësive Kavajë dhe Rogozhinë.

**Uji Pa të Ardhura rezulton në nivelin 75.44%** të ujit që hyn në sistem dhe faturohet vetëm në nivelin 24.56% të prodhimit.

**Tabela 7** paraqet komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2022, për Sh. Rajonale UK Durrës.

**Tabela 7. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Durrës – Viti 2022**

Emërtimi	Viti 2022	Ndaj Ujit të Prodhuar (në%)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	<b>55,581,999</b>	<b>100.00%</b>
Konsumi i ujit të faturuar i matur	11,686,796	21.03%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	1,966,122	3.54%
<b>Faturimi total</b>	<b>13,652,918</b>	<b>24.56%</b>
<b>Konsumi i autorizuar i pa faturuar</b>	<b>91,582</b>	<b>0.16%</b>
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit	11,826,432	21.28%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës	6,031,437	10.85%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	1,870,414	3.37%
<b>Humbjet e dukshme (administrative)</b>	<b>19,728,283</b>	<b>35.49%</b>
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	4,019,108	7.23%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	689,141	1.24%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit	804,846	1.45%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes	15,706,802	28.26%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjetës	889,319	1.60%
<b>Humbjet Reale të ujit (teknike)</b>	<b>22,109,216</b>	<b>39.78%</b>
<b>Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)</b>	<b>41,837,499</b>	<b>75.27%</b>
<b>UJI PA TË ARDHURA</b>	<b>41,929,081</b>	<b>75.44%</b>

**Komente:**

- Treguesi UPA në nivelin **75.44%** të prodhimit vjetor, është në nivele mjaft të pakënaqshme dhe kërkon angazhim serioz pasi rrezikon qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë.
- Niveli i matjes për faktorin “Uji i Prodhuar”(83%) si dhe konsumi i matur (86%) kërkojnë impenjim dhe planifikim të fondeve deri sa të arrihet matja deri në 100% e prodhimit.
- Humbjet nga lidhjet e paligjshme në rrjetin e transmetimit (21.28%) dhe atë të shpërndarjes prej 10.85% janë në nivele të larta dhe kërkojnë ndërhyrje urgjente nëpërmjet task-forcës.
- Humbjet teknike (39.78%) konsiderohen të larta dhe në nivele të pa pranueshme që duhen përmirësuar, ato shkaktohen kryesisht nga humbjet në rrjetin e shpërndarjes (28.26%) dhe të transmetimit (7.23%) për të cilat shoqëria duhet të bëjë analizën e duhur për të gjetur arsyet dhe zgjidhjet e duhura për reduktimin e tyre.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve kryhet pjesërisht me zona të ndara me matje (DMA), në përgjithësi hasen vështirësi për monitorimin e humbjeve dhe hartimin e bilancit të ujit nga të gjitha njësitë që përbëjnë shoqërinë rajonale. Trajnimi i stafit është i domosdoshëm në veçanti për ish shoqëritë UK Krujë, Kavajë dhe Rrogozhinë.

**Rekomandime:**

- *Të bëhen përpjekje për sigurimin e fondeve për të projektuar dhe zbatuar sisteme DMA në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë të cilat mundësojnë një monitorim, diagnostikim dhe marrjen e masave për uljen e humbjeve në sistemet e furnizimit me ujë, si dhe hartimin e një bilanci korrekt të ujit.*
- *Të trajnojnë vazhdimisht stafin teknik në programet kombëtare të humbjeve të ujit të organizuara nga SHUKALB dhe më gjerë, si dhe të caktojë një person përgjegjës për*

*monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara, për hartimin e bilancit të ujit për çdo DMA dhe për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë rajonale.*

- *Shoqëria duhet të marrë masa për gjetjen e fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e ujëmatësve në çdo burim si domosdoshmëri për hartimin e një bilanc uji sa më real.*
- *Shoqëria duhet të gjejë fonde për të rritur përqindjen e konsumatorëve familjare me matës që ky tregues të jetë sa më afër nivelit 100%, për të mundësuar një menaxhim racional të kërkesës për ujë, si dhe minimizimin e humbjeve të dukshme, të cilat janë në nivele mjaft të larta.*
- *Hartimi i një plan veprimi me prioritete instalimin e matësve në shtëpitë private dhe kryesisht në zonat rurale.*
- *Në lidhje me përqindjen e lartë të lidhjeve të paligjshme, shoqëria duhet të ndërmarrë plan veprimi për të përcaktuar sa më saktësisht bazën e klientëve bazuar edhe në bazën e klientëve të OSHEE-së.*
- *Të ngrihet një Task Force e cila në bashkëpunim me degën e shitjes, të realizojë në terren verifikime për anashkalim të ujëmatësit me lidhje dytësore apo klientë të paregjistruar me kontratë me shoqërinë, si dhe kontrollin e punës së lexuesve të matësve dhe në përgjithësi për evidentimin e problematikës me ujin e nën faturuar.*
- *Të krijojë dhe të mirëmbajë të gjitha sistemet e informacionit, për të patur raportim të saktë dhe të besueshëm të të dhënave të kërkuara, në lidhje me bilancin e ujit dhe çdo informacioni tjetër që mund të kërkohej.*
- *Për korrigjimin e normave të faturimit me matje, shoqëria duhet të angazhohet në gjetjen e lidhjeve dyfishe. Për çdo lidhje pa matës, në pamundësi për vendosjen e matësit, nëpërmjet faturuesve duhet të verifikohet numri i banorëve (certifikatë familjare) për çdo lidhje dhe më pas të faturohen sipas VKM nr.102, datë 16.03.1992.*
- *Problematika në disa raste nuk është e njëjtë për çdo njësi. Për këtë duhet ti referohet problematikës në bilancin përkatës të çdo Njësie të veçantë.*
- *Të rrisë bashkëpunimin me ERRU-në për të tejkaluar vështirësitë në hartimin e bilancit të ujit dhe të dorëzojë atë në kohë pranë ERRU-së. Bilanci i ujit duhet të dorëzohet çdo 6 muaj, vërtetësia dhe saktësia e të dhënave të bilancit do të vlerësohet nga ERRU si penalitet ose bonus për shoqërinë raportuese.*